

**VENDIM**  
**Nr. 784, datë 28.12.2023**

**PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR**  
**Z. FEDERIK KOLË NDOCI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Federik Kolë Ndoci, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**